



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Niko PELESHI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në garantimin e ushtrimit të së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me standardet kushtetuese dhe legjisacionin në fuqi;

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij institucioni në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe besimit të publikut ndaj institucioneve shtetërore;

Duke vlerësuar veprimtarinë e institucionit në drejtim të monitorimit të zbatimit të legjisacionit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nga autoritetet publike dhe subjektet përkatëse;

Duke vlerësuar angazhimin e institucionit në trajtimin e ankesave administrative, zhvillimin e hetimeve administrative dhe ndjekjen e respektimit të detyrimeve ligjore nga institucionet publike;

Duke vlerësuar kontributin e institucionit në forcimin e transparencës proaktive, promovimin e të dhënave të hapura dhe rritjen e ndërgjegjësimit për standardet e mbrojtjes së të dhënave personale;

Duke vlerësuar rolin e institucionit në kuadër të procesit të integritetit evropian, veçanërisht në drejtim të përafrimit të legjisacionit dhe standardeve me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për informim;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2025 dhe vlerëson:

Vijimin e monitorimit të autoriteteve publike për zbatimin e legjisacionit për të drejtën e informimit dhe publikimin e informacionit me interes publik.

Angazhimin në drejtim të forcimit të transparencës proaktive dhe monitorimit të programeve të transparencës në institucionet publike.

Trajtimin e ankesave administrative të qytetarëve dhe ndjekjen e rasteve që lidhen me mosdhënien ose kufizimin e aksesit në informacionin publik.

Vijimin e hetimeve administrative dhe ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse në funksion të garantimit të respektimit të së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontributin në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për informim në përputhje me standardet evropiane.

Angazhimin në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe forcimit të kapaciteteve të autoriteteve publike për zbatimin korrekt të legjislacionit në këto fusha.

Bashkëpunimin institucional me autoritetet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë në funksion të promovimit të standardeve të transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Vijimin e përpjekjeve për promovimin e të dhënave të hapura dhe rritjen e aksesueshmërisë së informacionit publik për qytetarët.

Angazhimin në drejtim të forcimit të standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale në institucionet publike dhe subjektet që përpunojnë të dhëna personale.

Kontributin e institucionit në forcimin e kulturës së transparencës, llogaridhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve në përputhje me standardet demokratike dhe procesin e integritetit evropian.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2026, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të vijojë forcimin e asistencës teknike dhe ligjore që informacioni i publikuar nga autoritetet publike të jetë i plotë, i përditësuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për një transparencë proaktive dhe funksionale për qytetarët sipas Modeleve të Programit të Transparencës për Autoritetet Publike dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore.

2. Të intensifikohet monitorimi për autoritetet me nivel të ulët ose minimal transparence me qëllim përmirësimin e përputhshmërisë me detyrimet ligjore.

3. Të kontribuojë në standardizimin e interpretimit të kufizimeve ligjore për aksesin në informacion.

4. Të intensifikojë përpjekjet për të orientuar dhe mbështetur institucionet publike në zbatim të njëtrajshëm të detyrimeve për publikimin e të dhënave të hapura duke nxitur përdorimin e formateve të përshtatshme, të licencave standarde dhe duke sqaruar dallimin ndërmjet të dhënave të hapura dhe programit të transparencës.

5. Të përditësohet Regjistri i Nëpunësve për Mbrojtjen e të dhënave Personale si dhe të punohet për ndërgjegjësimin e rolit të tyre.

6. Të përmirësohen mekanizmat e ndjekjes së rekomandimeve përmes raportimit periodik për zbatimin e tyre.

7. Të kryejë një vlerësim të plotë për zbatimin në praktikë të akteve nënligjore të miratuara në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me qëllim evidentimin e vështirësive, boshllëqeve dhe ndikimit real në zgjidhjen e rasteve konkrete brenda tremujorit të tretë të këtij viti.

8. Të intensifikojë fushatat informuese për qytetarët, me fokus në mënyrat praktike të ushtrimit të të drejtave dhe mekanizmat e ankimit për mbrojtjen e të dhënave personale.

9. Të kontribuojë në hartimin e programeve periodike të trajnimit të detyrueshme për administratën publike dhe subjektet private që përpunojnë të dhëna personale.

10. Të hartojë dhe publikojë udhëzues për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet publike dhe private në zbatim të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

11. Të pasqyrojë në raportin vjetor të veprimtarisë së tij ankesat dhe verifikimet në lidhje me procesin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, në të dyja fushat e mandatit të tij.

12. Të vijojë monitorimin e rregullt të transparencës proaktive të institucioneve përgjegjëse për publikimin e informacionit për kontratat publike sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

13. T’i kushtohet vëmendje e veçantë përpunimit të të dhënave personale të kategorive vulnerabël, fëmijëve, personave me aftësi ndryshe, si dhe pacientëve në sistemin shëndetësor.

14. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda tremujorit të tretë të këtij viti.

Miraturar në datën 30.6.2026